

V E N D I M
Nr.519, datë 25.9.1995

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.356, DATË
12.6.1995 "PËR RATIFIKIMIN E AKTEVE TIP TË THEMELIMIT TË SHOQËRIVE
SHTETËRORE"**

Me propozimin e Ministrisë së Burimeve Minerare dhe Energjetike dhe të Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.356, datë 12.6.1995, në statutin e shoqërisë anonime të bëhen këto ndryshime:

1. Në nenin 1, në fund të shtohet "Territori i shoqërisë është...".

2. Në nenin 2, në fund të shtohen fjalët "pa cenuar objektin e shoqërisë".

Në këtë nen, në paragrafin e dytë, fjalia e dytë që fillon me fjalët "Kjo përfshin..." deri në fund të nenit do të hiqet nga statuti i shoqërive pilot të sistemit energjetik.

3. Në nenin 4, në fund shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Ky nen nuk zbatohet për shoqëritë që veprojnë në sektorët e naftës, minierave dhe energjisë elektrike, aksionet e të cilave shiten sipas legjislacionit përkatës të privatizimit të secilës prej tyre".

4. Në nenin 6, në pikën 1, në fund të shtohet kjo fjali: "Me përjashtim të shoqërive që veprojnë në sektorët e naftës, minierave dhe energjisë elektrike, ku 2/3 emërohen nga ministri i Burimeve Minerare dhe Energjetike dhe 1/3 nga ministri i Financave".

Në këtë nen shtohet pika VII me këtë përmbajtje:

"VII. Ky këshill do të funksionojë deri në momentin e shitjes së aksioneve. Pastaj shoqëria do të funksionojë në përputhje me legjislacionin në fuqi".

5. Në nenin 12, në fund, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Është e detyrueshme që çdo marrëdhënie ndërmjet drejtorit të përgjithshëm dhe këshillit mbikëqyrës të regjistrohet ose të pasqyrohet në procesverbal.

Marrëdhëniet brenda shoqërisë përcaktohen me rregullore të veçanta, të cilat miratohen në këshillat mbikëqyrës të këtyre shoqërive".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi